

Më
Data

05 - 11 - 2018

REPublika e Kosovës
REPublika e Kosovës – Republic of Kosovo
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:044673
Datë: 25.09.2018
Numri i dokumentit: 00130960

P.nr.1162/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi dhe praktikanten Qëndresa Meha, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 pa.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr. 1672-1/2018 e datës 07.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me datë 14.09.2018, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja, të akuzuarit [REDACTED] të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.17.09.2018, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga fshati [REDACTED], Shterpcë, i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i gjinisë [REDACTED] i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, i pa punësuar, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, gjendet në arrest shtëpiak nga data 14.08.2018.

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.14.08.2018 rreth orës 12:32 në rrugën "Skenderbeu", Restoranti London në Ferizaj, i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme e ka privuar nga liria [REDAKTUAR] në atë mënyrë që deri s e dëmtuara ishte me motrën e sajë [REDAKTUAR] në Restorant, me forcë e nxjerr jashtë dhe e fut brenda në veturën e tij të markës Chervollet, me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], ngjyrë e kuqe dhe niset në drejtim të fsh. Firajë, i akuzuari gjatë rrugës iu kishte drejtuar të dëmtuarës me fjalët kërcënuese Ti ja ki me tregu me kënd ke dal mbrëmë, ja ki me vdek sonte , me te arritur tek një shtëpi e pabanuar, e ndal veturën e fut brenda duke iu drejtuar me fjalët Me kënd ke dal mbrëmë se të lidhi me litarë, më pas vazhdojnë në drejtim të fsh. Brod, e ndalojnë policia dhe të akuzuarin e arrestojnë.

me të cilën ka kryer veprën penale Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 pa.1 të KPRK-së,

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 46 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-ës,

SHQIPTON

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 800/ tetëqind euro/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, duke iu llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.14.08.2018 deri me dt. 13.09.2018.

Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi.

E dëmtuara [REDAKTUAR] nga fsh [REDAKTUAR] Shterpçë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 €, si dhe shumën prej 30 € në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të cilat do ti paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar si PP/II.nr.1672-1/2018 të datuar më 07.09.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 pa.1 të KPRK-së,

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësorë me datë 14.09.2018, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin për veprën penale të kryer si dhe duke premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.

Prokurorja e Shtetit Mimoza Syla duke paraqitur mendimin e sajë përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh mendimin e Prokurorit të Shtetit, deklarimit të pandehurit, shqyrtoi me kujdes faktet e përcaktuara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë; vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, mesazhet telefonike, fotografitë të dëmtuarës si dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 pa.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale përkatësisht që në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer të kryer se deri më tani nuk rezulton të jetë dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, nuk gjeti ndonjë rrethanë

...nese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasysh mendimin e prokurorit të shtetit, të pandehurit është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr. 1162/18, me datë 17.09.2018.

Praktikantja

Qendresa Meha

Gjyqtari,

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.